



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E MIRËADMINISTRIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE, ASETIVE DHE SHËRBIMEVE

Nr. 7263/5 Prot.

Tiranë, më 28.8.2019
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

Lënda: Njoftim për fillimin e ecurisë disiplinore

Z. NDRIÇIM MEHMETI

PËRGJEGJËS SEKTORI NË SEKTORIN E PËRGATITJES DHE FIZIBILITETIT TË
PROJEKTEVE PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

DREJTORIA E KONCEPTIMIT DHE FIZIBILITETIT TË PROJEKTEVE TË ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME TË POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË

Tiranë

Bazuar në nenet 57-61, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, dhe të udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe të shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, në cilësinë e eproprit direkt, ju vë në dijeni se ndaj jush ka filluar procedura e ecurisë disiplinore për dhënien e masës “*largim nga shërbimi civil*”, me motiv: a) “*braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për 7 ditë pune ose më shumë, kur mungesa ka sjellë pasoja shumë të rënda në përmbushjen e detyrave të institucionit*”, referuar mosparaqitjes suaj në kryerjen e detyrave në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ju njoftoj gjithashtu se, në zbatim të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil” dhe të udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe të shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, keni të drejtën:

- për të paraqitur me shkrim sqarimet tuaja rreth shkeljes disiplinore;
- për paraqitjen e provave, thirrjen e dëshmitarëve, inspektimin e dosjes;
- për tu paraqitur me punonjësin më të vjetër të institucionit;
- për tu dëgjuar vetë apo me përfaqësues ligjor;
- për të paraqitur dëshmitarë.

Në rast të mosparaqitjes suaj të përsëritur, procedimi disiplinor do të vazhdojë në mungesë.

Dokumentacionin provues të shkeljes së pretenduar e gjeni të plotë bashkëlidhur njoftimit, ku mund të merrni dijeni për të gjithë dosjen përkatëse.

Seanca dëgjimore është më datë 29.08.2019, ora 11:00, në MASR.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



Oltjon MUZAKA